



THIRRJE PËR KOMPANI QË OFROJNË SHËRBIMIN MAKINA ME QERA - PROJEKTI “TË RINJ AKTIVË PËR DEMOKRACI QYTETARE 2”

Titulli:	Kompani shërbimi “Makinë me qera”
Vendndodhja:	Tiranë, Shqipëri
Fillimi i kontratës:	13.10.2023
Fundi i kontratës:	30.06.2024

Përshkrimi

Situata aktuale në Shqipëri, pavarësisht përmirësimeve, vazhdon të tregojë një diferencë të konsiderueshme për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve, grave dhe komuniteteve të margjinalizuara në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Shkaku kryesor i kësaj mangësie varion nga pabarazia gjinore tek mungesa e kapaciteteve dhe programeve të institucioneve për t'u ofruar brezave informacion të saktë mbi procesin e vendimmarrjes dhe demokracinë qytetare. Në këtë situatë, iniciativat e arsimit joformal paraqesin mundësi shtesë për të përmbushur nevojat e komuniteteve të pashërbyera, për të promovuar angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Duke marrë parasysh situatën e sipërpërmendur, Qendra po zbaton projektin "Të rinj aktivë për demokraci qytetare 2", në Bashkinë Patos. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të nxisë dhe promovojë angazhimin qytetar të të rinjve përmes pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale.

Objektivi

Qendra Europiane është duke kërkuar ofrimin e shërbimit të makinave me qera ditore, e cila do të përdoret për transportin e stafit të projektit nga Tirana në Patos dhe anasjelltas gjatë implementimit të projektit.

Kriteret e nevojshme

- Subjekti duhet të jetë i regjistruar pranë autoriteteve fiskale;
- I pajisur me numër NIPT-i.
- Të ofrojë shërbimin nga Tirana;
- Të ketë kapacitetet e nevojshme për të mbuluar me mjete transporti në datat e parashikuara;

Oferta financiare

- Ofruesi i shërbimit është i lutur të dërgojë disa alternativa të makinave me vlerën financiare bashkëlidhur.
- Në rast dakordësimi, Ofruesi i shërbimit do të njoftohet me e-mail.

Të gjithë të interesuarit janë të lutur të dërgojnë ofertën e tyre financiare deri në datën 10 tetor 2023 në adresën e e-mailit europcentrefoundation@gmail.com ose nëpërmjet postës në adresën rruga Vaso Pasha, Pl. 20/57, Tiranë, Shqipëri.